



Prishtinë, 04 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1418_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 26 paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.10, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për EnergjiElektrike (Ligji Nr.05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10, Nenin 4, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 23 dhe Kapitullit VI të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës 07.05.2021 për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, të dorëzuar në Rregullator nga ndërmarrja GSA ENERGJI SH.P.K, adresa: Rr. Xheladin Hana, Obj. 35/15, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 04 tetor 2021, nxori këtë:

VENDIM

- I. I VAZHDOHET Licenca për furnizim me energji elektrike ndërmarrjes GSA ENERGJI SH.P.K (e lëshuar me datë 11.11.2016 deri 10.11.2021) me numër licence ZRRE/Li_48/15 për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 11 nëntor 2021 deri 10 nëntor 2026.
- II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për GSA ENERGJI SH.P.K. të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) me datë 07.05.2021 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike nga përfaqësues të ndërmarrjes GSA ENERGJI SH.P.K.
- o Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duke dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
- o Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja GSA ENERGJI SH.P.K me datë 07 shtator 2021 ka njoftuar përmes gazetave palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.
- o Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh



kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim nga palët e interesit, për këtë aplikacion.

- o Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
 - o Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas udhëzimeve të rregullatorit, aplikacioni është konsideruar i kompletuar, kështu që Bordi i Rregullatorit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 - o Licenca e lëshuar do të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence **jo më vonë se gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 15 të Licencës së lëshuar nga Rregullatori dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- III. Licenca për furnizim me energji elektrike i lejon të licencuarit të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin për energjinë në fuqi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit **GSA ENERGJI SH.P.K**
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe

Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar